



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT KUKES

Nr. 386 Prot

Kukes, me 08.09.2014

Lenda :Raport I Konsultimit me publikun.

Drejtuar: AGJENSISE KOMBETAR TE MJEDISI

Drejtoria e Vlersimit Mjedisor

RRUGA; "Sami Frasheri ", Nr.4, Tirane

Bashkëngjitur shkresës ju dërgojmë rraportin e Konsultimit me publikun per subjektin "Trade Minerals-AL". Per shfrytezim minerali Baker ne zonen minerale nr.90/1.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj!





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT
QARKU KUKES

RAPORT

Konsultim me Publikun Subjekti TRADE MINERALS-AL

Ne baze te detyres se dhene nga Drejtori I DRM-Kukes me autorizimin perkates Nr. 384 Prot. Date 05.09.2014 per konsultimin me publikun mbi Shfrytezimin e mineralit te bakrrit nga firma Trade Minerals-Al ne zonen minerare nr. 90/1 fshati Gjegan, Rrethi Kukës, Qarku Kukës.

Me date 05.09.2014 ora 14.00 u be konsultimi me publikun (me banore te zones afer zones minerare) ne fshatin Gjegan ne afersi te lejes minerare nr. 90/1.

Te pranishem ne kete konsultim ishin: Perfaqesues te subjektit, perfaqesues te DRM-Kukes si dhe banore te zones perreth.

Mbas prezantimit te projektit nga perfaqesues te subjektit u sqaruan banoret mbi menyren e shfrytezimit dhe i gjithë impakti ne mjedis per kete projekt shfrytezimi minerali ne kete zone.

Te gjithë banoret nuk ishin kunder ketij projekti ne parim, por shqetesimi I tyre ishte I lidhur me problemin e rreshqitjes se tokes mbi zonen minerare e cila eshte problem I shfaqur prej shume vitesh nga shfrytezimi I bere ne kete zone perpara viteve 90" dhe mendojne se gjate shfrytezimit problemi do te thellohej edhe me shume. Tjeter problem I ngritur nga banoret eshte edhe kompesimi per pronat dhe demet e shkaktuara nga aktiviteti minerar I meparshem, si dhe me pare te behet rehabilitimi pastaj te fillojne punimet per shfrytezim. Disa prej banoreve qe moren pjese ne takim u shprehen se pasojet jane mjaft te renda dhe se nuk duam qe ato te shtohen edhe me shume.

Nga ana mjedisore theksojme se zone ne fjale eshte nje nder zonat me te demtuara ne shqiperi nga shfrytezimi per nje kohe te gjate I mineralit te bakrrit, rrjedhjeve te ujrave acide nga galerite dhe ndotjes se tokes nga mikroelemente te bakrrit. Zona minerare nr. 90/1 theksojme se eshte Brenda kesaj zone.

Subjekti eshte I detyruar te zbatoje me perpikmeri te gjitha rekomandimet nga specialistet e VNM per te bere te mundur zbatimin e projektit me ndikime sa me te pakte ne mjedis si gjate ndertimit dhe funksionimit te projektit. Dhe zbatimin rigoroz pe programit te monitorimit dhe rehabilitimi te zones.

Nr pjesmarresve 19 (nentembedhjete).


Specialiste te DRM-Kukes

Kukes me 14.08.2014

1. Besnik Hallaçi
2. Mirush Kerxhaliju



Pamje nga Takimi me Publikun e subjektit TRADEMINERALS-AL



A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.